

V E N D I M
Nr.579, datë 9.12.1994

PËR BUXHETIN PROVIZOR TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 20 të ligjit nr.7616, datë 30.9.1992 “Për hartimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Departamentit të zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rastet kur buxheti i vitit nuk është miratuar nga Kuvendi Popullor deri në 20 janar të vitit buxhetor përkatës, atëherë Këshilli i Ministrave miraton financimin e investimeve nga buxheti për një periudhë deri në 3 muaj. Kufiri maksimal i lejuar për financimin e investimeve të jetë në masën 25 për qind të buxhetit të investimeve të një viti më parë.

2. Në përcaktimin e projekteve që do të financohen deri në miratimin e buxhetit të vitit nga Kuvendi Popullor, të ndiqet kjo renditje prioritare:

a) Kostoja lokale e projekteve në proces që financohen me ndihma e kredi dhe që janë miratuar nga Kuvendi Popullor.

b) Objekte të filluara në vitin e mëparshëm, por ende të papërfunduara deri në fund të vitit që ato ishin miratuar.

c) Objektet që ishin parashikuar në vitin e mëparshëm, për të cilat është nënshkruar kontrata e fillimit të punimeve, por për arsye të përligjura punimet nuk kanë filluar.

d) Objektet e parashikuara në vitin e mëparshëm dhe për të cilat nuk është nënshkruar kontrata e fillimit të punimeve, por ato konsiderohen në programin e zhvillimit ekonomik si objekte me përparësi të lartë.

e) Objekte të reja që janë të pranishme në buxhetin e çdo viti, si ndërtimi i rrugëve të reja, përmirësimi i atyre ekzistuese dhe ujësjellësve të vegjël, deri në masën e realizimit faktik të vitit të kaluar.

3. Financimi për objektet e përfshira në buxhetin provizor duhet të mbulojë nevojat vjetore të financimit për çdo objekt.

4. DZHEKN, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, harton listën me objektet e investimeve të financuara nga buxheti provizor. Kjo listë e objekteve miratohet nga Këshilli i Ministrave, së bashku me buxhetin provizor të paraqitur nga Ministria e Financave.

‘5. Shuma e parashikuar për investime në buxhetin provizor është pjesë përbërëse e buxhetit të vitit të ri buxhetor.

6. Kryerja e shpenzimeve për llogari të buxhetit provizor pas miratimit nga Kuvendi Popullor të buxhetit për vitin e ri buxhetor është kategorikisht e ndaluar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi